

# RAIFFEISEN BANK SH.A.

## Raporte Financiare 3-Mujore

Për periudhën e mbyllur më: 30/09/2020

Sipas Kerkesave te Rregullores Nr. 60, datë 29.08.2008 [i ndryshuar] te Bankes se Shqiperise

<b>PERMBAJTJA:</b>	<b>Faqe</b>
1. Bazat e pergatitjes dhe Permbledhje e Politikave Kontabel	1 - 6
2. Tregues te rentabilitetit te bankes	7
3. Pozicioni financiar, Pasqyra e te Ardhurave dhe zerat jashte bilanci te permbledhura	8 - 11
4. Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit	12
5. Pasqyra e rrjedhjes së parasë	13
6. Klasifikimi i portofolit te kredive sipas shperndarjes gjeografike (rretheve)	14 - 15
7. Klasifikimi i portofolit te kredive sipas tipit te industrise dhene rezidenteve (rretheve)	16 - 17
8. Fondet per provigjone dhe levizjet gjate periudhes	18
9. Aktivitet sipas maturimit përfundimtar	19
10. Pasivet sipas maturimit përfundimtar	20
11. Struktura e kapitalit rregullator; Raporti i mjaftueshmërise së kapitalit: Kërkesa për kapital rregullator për mbulimin e rrezikut të tregut dhe rrezikut operacional	21

## **1. TË PËRGJITHSHME**

Raiffeisen Bank sh.a (“Banka”) është një institucion bankar i themeluar në përputhje me Ligjin 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” datë 14 prill 2008 dhe me Ligjin 9662 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë” datë 18 dhjetor 2006 si edhe ligje të tjera të aplikueshme.

Bazuar në nenin nr.2 të Statutit të të Bankës, objektivi i Bankës është të veproje, për llogari të vet apo të palëve të treta, çfarëdo dhe çdo operacion të pranuar apo të deleguar Bankës sipas legjislacionit përkatës. Raiffeisen Bank sh.a. është krijuar dhe themeluar si dhe operon vetëm në Shqipëri.

Raiffeisen Bank sh.a. është shoqëri e zotëruar nga Raiffeisen SEE Region Holding GmbH, Austri me 100 % të kapitalit.

Më 30 Shtator 2020, Banka operon me një rrjet bankar prej 76 pika shërbimi në të gjithë Shqipërinë (31 dhjetor 2019: 76 pika shërbimi), të cilat drejtohen nga 6 Distrikte. Numri i punonjësve të Bankës më 30 Shtator 2020 është 1,289 punonjës (31 dhjetor 2019: 1,293).

## **2. BAZAT E PËRGATITJES**

Pasqyrat financiare individuale të Bankës janë përgatitur në përputhje me “Metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare” (“Metodologjia e Raportimit Financiar” ose “MRF”) e miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. MRF u miratua për qëllime rregullatore, në zbatim të Nenit 47 të Ligjit nr. 9662, datë 18 dhjetor 2006 “Për Bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Pasqyrat financiare individuale janë prezantuar në Lekë Shqiptare (“Lek”), të përafuar në mijë Lek dhe janë të përgatitura mbi bazën e kostos historike, përveç letrave me vlerë të disponueshme për shitje dhe letrave me vlerë të tregtueshme, të cilat vlerësohen mbi bazën e vlerës së tregut.

## **3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL**

### **3.1 Transaksionet në monedhë të huaj**

#### **(i) Monedha funksionale dhe prezantuese**

Pasqyrat financiare individuale janë prezantuar në Lek, cila është monedha funksionale dhe prezantuese e Bankës.

#### **(ii) Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet e kryera në monedha të huaj janë regjistruar fillimisht me kurset e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në këto monedha, janë rikonvertuar me kurset e këmbimit të datës së bilancit. Fitimet dhe humbjet që rezultojnë nga këmbimi janë paraqitur në pasqyrën individuale të të ardhurave. Aktivet dhe detyrimet jomonetare në monedha të huaja janë konvertuar me kurset e këmbimit të datës së transaksionit. Kapitali aksioner është konvertuar me kursin e këmbimit të datës së bilancit. Diferenca ndërmjet kostos historike dhe gjendjes duke përdorur kursin e këmbimit të datës së bilancit njihen si Diferenca nga Rivleresimi në Kapital.

Kurset e këmbimit që janë aplikuar më 30 Shtator 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 (Lek në monedhë të huaj) për monedhat e huaja kryesore janë paraqitur më poshtë:

	30 Shtator 2020	31 Dhjetor 2019
Dollari Amerikan (USD)	105.99	108.64
Monedha Europiane (EUR)	124.05	121.77
Paundi Britanik (GBP)	135.94	143.00

### 3.2 Arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore

Për të raportuar fluksin e parasë, paraja dhe ekuivalentët e saj janë përcaktuar si arka dhe llogaritë me Bankën Qëndrore, duke përfshirë rezervën minimale të detyrueshme me Bankën e Shqipërisë (“Banka Qëndrore”).

Rezerva minimale e detyrueshme me Bankën e Shqipërisë është një rezervë që duhet ta mbajnë të gjitha bankat tregtare të licensuara në Shqipëri.

### 3.3 Investime në letra me vlerë

Investime në letra me vlerë përfshijnë bono thesari, obligacione të Qeverisë dhe obligacione të huaja. Këto investime maten fillimisht me kosto, duke përfshirë kostot e transaksionit dhe klasifikohen si më poshtë:

- Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim
- Letra me vlerë të disponueshme për shitje, dhe
- Letra me vlerë të tregtueshme

#### (i) Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Investimet që kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe për të cilat Banka ka qëllimin dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim, regjistrohen pas njohjes fillestare me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke zbritur provigjonet për rënien në vlerë.

#### (ii) Letra me vlerë të disponueshme për shitje

Letrat me vlerë të disponueshme për shitje përfshijnë bono thesari dhe obligacione të huaja. Pas vlerësimit fillestar, letrat me vlerë, të cilat klasifikohen si të disponueshme për shitje, rivlerësohen me vlerën e tregut. Humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë të disponueshme për shitje përfshihen në fitimin ose humbjen neto për periudhën në të cilën ndodhin këto ndryshime.

#### (iii) Letra me vlerë të tregtueshme

Letrat me vlerë të tregtueshme përfshijnë bono thesari. Letrat me vlerë të tregtueshme regjistrohen në ditën e blerjes dhe me çmimin e blerjes duke përfshirë kostot dhe interesin e përlllogaritur. Pas njohjes fillestare, letrat me vlerë të tregtueshme rivlerësohen me vlerën e tregut. Fitimet dhe humbjet si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerën e tregut të këtyre letrave me vlerë përfshihen në fitimin ose humbjen neto të periudhës në të cilën ndodhin këto ndryshime.

#### (iv) Vlera e tregut

Vlera e tregut për letrat me vlerë që tregtohen në tregje financiare të organizuara përcaktohet duke iu referuar çmimeve të ofruara (bid) të kuotuar gjatë mbylljes së bursës në datën e bilancit. Për letrat me vlerë për të cilat nuk ekziston një çmim i kuotuar në bursë, një vlerësim i arsyeshëm i vlerës së tregut përcaktohet duke iu referuar vlerës aktuale të tregut të një instrumenti tjetër, i cili është i përafërt në natyrë. Vlera e tregut, gjithashtu, mund të bazohet në rrjedhjen e pritshme të parasë, ose mbi bazën neto të aktivitetit për letrën me vlerë në fjalë.

#### (v) Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes

Letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve për t'u rishitur (marrëveshje të anasjellta të riblerjes) dhe letrat me vlerë të shitura sipas marrëveshjeve për t'u riblerë (marrëveshje riblerjeje) në përgjithësi trajtohen si veprime financiare të kolateralizuara dhe mbahen me shumat e dhëna ose të marra, plus interesin e përlllogarit. Interesi nga marrëveshjet e anasjellta të riblerjes dhe për marrëveshjet e riblerjes shprehet si e ardhur ose shpenzim interesi gjatë kohëzgjatjes së çdo marrëveshjeje. Të gjitha këto marrëveshje bëhen me Bankën e Shqipërisë.

### 3.4 Huatë dhe paradhëniet për klientët

Huatë që Banka i jep huamarrësve duke i siguruar atyre para në mënyrë të drejtpërdrejtë, kategorizohen si hua të dhëna nga Banka dhe mbarten me vlerën e mbetur, pakësuar nga provigjionet për rënien në vlerë. Të gjitha huatë dhe paradhëniet kontabilizohen kur huamarrësve iu disbursohet shuma totale në para.

Përveç provigjioneve të përgjithshme të njohura në bilancin e Bankës, një provigjion për rënien e vlerës së huasë përcaktohet nëse është e qartë që Banka nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjithë shumën e pashlyer të detyrimit.

Politika huadhënëse e Bankës është në përputhje me ligjet në fuqi (Ligji për Bankat dhe Rregullorja e Bankës së Shqipërisë “Për Administrimin e Rrezikut të Kredisë nga Bankat dhe Deget e Bankave të Huaja” miratuar me vendimin nr. 62 datë 14.09.2011, ndryshuar me vendimin nr.27, datë 27.03.2013, ndryshuar me vendim nr. 22, datë 27.02.2014 dhe ndryshuar me vendim nr. 26, datë 01.04.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë). Banka e klasifikon portofolin e huasë në pesë kategori duke aplikuar normat e mëposhtme për krijimin e fondeve rezervë të provigjioneve:

Kategoria e huasë	Provigjioni i humbjes
Standarde	1%
Në ndjekje	5%
Nënstandarde	20%
Të dyshimta	50%
Të humbura	100%

Kur huaja është e pakthyeshme, ajo anulohet me provigjionin për huatë e këqija, shumat e rikuperueshme më pas kreditohen në pasqyrën individuale të të ardhurave në zërin “Të ardhura / (shpenzime) të tjera operative”.

Banka nuk përlllogarit më interes mbi huatë e klasifikuara të humbura për shkak të falimentimit të klientit ose moskthimit në afat të huasë. Vlera e mbetur e huave, për të cilat nuk përlllogaritet interes, përfaqëson shumën për t'u marrë minus provigjionin për humbjet e pritshme. Provigjioni zakonisht përcaktohet si 100% e vlerës për t'u marrë.

### *Politikat e fshirjes së kredive*

Banka fshin një hua/letër me vlerë (dhe çdo provigjon për humbjet nga rënia në vlerë) kur Komiteti i Kredive Problematike të Bankës vendos që huatë/letrat me vlerë janë të paarkëtueshme. Ky përcaktim arrihet pasi janë marrë në konsideratë informacione si ndodhja e ngjarjeve të konsiderueshme, të cilat kanë ndikuar në gjendjen financiare të huamarrësit në mënyrë të tillë që ai nuk është në gjendje të paguajë detyrimin, ose të ardhurat nga ekzekutimi i kolateralit nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin total.

### **3.5 Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara**

Mjetet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara shprehen me koston historike të blerjes plus rivlerësimet (në rastin e ndërtesave) minus zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Ndërtesat shprehen me vlerat e rivlerësuara, të cilat janë vlerat reale në bazë të përdorimit aktual në datën e rivlerësimit, minus ndonjë zhvlerësim pasues të akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë vijuese të akumuluar. Rezultati i rivlerësimit është paraqitur në rezervat e rivlerësimit.

Zhvlerësimi dhe amortizimi paraqiten si pakësim i koston së mjeteve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara kundrejt periudhës së vlerësuar të përdorimit të tyre, duke përdorur metodën lineare, me pikënisje nga muaji i vënies së tyre në përdorim dhe jetëgjatësitë të vlerësuar për periudhën aktuale dhe atë krahasuese janë si vijon:

	30 Shtator 2020 (në vite)	31 Dhjetor 2019 (në vite)
• Ndërtesa	20	20
• Automjete	7	7
• Kompjuterat dhe pajisje informatike	4 deri në 7	4 deri në 7
• Software dhe Licensa	8	8
• Makineri dhe sisteme	7	7
• Pajisje për zyre dhe mobilje	5 deri në 7	5 deri në 7
• Përmirësimet e objekteve me qira	1 deri në 10	1 deri në 10

Toka dhe punimet në proces nuk zhvlerësohen.

Fitimet dhe humbjet nga shitja e ndërtesave dhe pajisjeve në përdorim paraqiten në pasqyrën individuale të të ardhurave në periudhën kur janë shitur ose nxjerrë jashtë përdorimit.

### **3.6 Pronat e rimarra në zotërim**

Në disa rrethana të caktuara, pronat e vëna në hipotekë mund të rimerren në zotërim pas heqjes të së drejtës mbi hipotekën e huave të këqija. Pronat e rimarra në zotërim vlerësohen me më të voglën midis vlerës së ankandit të fundit dhe vlerës së drejtë, pasi i janë zbritur kostot e shitjeve, dhe njihen në pasqyrat financiare individuale si “Aktive të tjera”. Qëllimi i Drejtimit ndaj pronave të rimarra në zotërim është shitja sa më e shpejtë e tyre, duke i përdorur të ardhurat nga shitja për uljen e borxheve të këqija.

### **3.7 Detyrimet ndaj klientëve**

Detyrimet ndaj klientëve shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përlllogaritjeje.

### **3.8 Detyrimet ndaj institucioneve financiare**

Detyrimet ndaj institucioneve financiare shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përlllogaritjeje.

### **3.9 Interesat dhe komisionet**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi janë regjistruar mbi bazë përlllogaritjeje.

Të ardhurat nga komisionet për llogaritë rrjedhëse, çequet, transfertat e parave dhe transaksionet e tjera bankare regjistrohen si të ardhura kur arkëtohen. Komisionet për huatë shtyhen në kohë dhe njihen gjatë jetës së huasë. Shpenzimet e komisionit regjistrohen kur shpenzimet janë paguar.

### **3.10 Shpenzimet**

#### **(i) Shpenzimet operative**

Shpenzimet operative regjistrohen kur ndodhin.

#### **(ii) Përfitimet e punonjësve**

- *Kontributi i detyrueshëm i sigurimeve shoqërore*

Banka derdh vetëm kontributin e detyrueshëm të sigurimeve shoqërore që siguron përfitim të pensionit për punonjësit kur dalin në pension. Qeveria e Shqipërisë ka përgjegjësi sigurimin e pragut minimal të pensionit në Shqipëri sipas një skeme pensioni me kontribut të përcaktuar. Kontributet e Bankës në skemën e kontributit të përcaktuar regjistrohen në pasqyrën individuale të të ardhurave kur ndodhin.

- *Leja vjetore e paguar*

Banka regjistron si detyrim koston e vlerësuar të paaktualizuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimit të punonjësit për periudhën e mbyllur.

#### **(iii) Përmirësimi i ambjenteve me qira**

Përmirësimi i ambjenteve me qira shprehet me koston historike të blerjes minus zhvlerësimin e akumuluar. Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën lineare përgjatë periudhës së qirasë. Sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, vlera e mbetur e përmirësimit të ambjenteve me qira përfshihet në aktive të tjera.

### **3.11 Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin më 30 Shtator 2020 llogaritet 15% (31 Dhjetor 2019: 15%) mbi fitimin e tatueshëm në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Fitimi i tatueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin para tatimit me disa të ardhura dhe shpenzime sipas kërkesave të legjislacionit shqiptar.

### **3.12 Pjesëmarrje në filial**

Banka zotëron 100% të aksioneve të Raiffeisen Leasing Sh.a. Raiffeisen Leasing Sh.a. është regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar sipas vendimit të Gjykatës së Tiranës Nr.35733 të datës 15 Maj 2006 dhe ushtron aktivitetin e qiradhënies financiare ashtu si parashikohet në legjislacionin shqiptar të aplikueshëm “Mbi Qiradhënien Financiare”.

Banka ka blerë 100% të aksioneve të Raiffeisen INVEST - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Sh.a. Blerja është aprovuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare bazuar në vendimin nr 30, datë 26 Mars 2009, regjistruar në Qendra Kombëtare e Regjistrimit më 23 Prill 2009.

### **3.13 Vlerësimi i vlerës së tregut**

Duke qenë se për instrumentat financiarë të krijuara në Shqipëri nuk ekziston asnjë treg, vlerësimet e vlerës së tregut bazohen në gjykimet rreth pritjeve të ardhshme të humbjeve, kushteve aktuale ekonomike, karakteristikave të riskut të instrumentave të ndryshëm financiarë dhe në faktorë të tjerë. Të vetmet instrumenta financiarë të gatshëm për t'u tregtuar janë letrat me vlerë shqiptare.

Vlerësimet e vlerave të tregut bazohen mbi instrumentet financiarë të bilancit individual ekzistues pa vlerësuar këtu vlerën e biznesit të pritshëm si dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumenta financiarë. Aktive dhe detyrime të rëndësishme, që nuk konsiderohen instrumenta financiarë, përfshijnë pronat, pajisjet dhe aktivet e patrupëzuara.

Në përgjithësi, instrumentat financiarë të bilancit individual të Bankës kanë një vlerë të vlerësuar tregu afërsisht të barabartë me vlerën e tyre kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtër apo të normave bazë të interesit, të cilat përafrojnë me normat e tregut. Shumica e instrumentave financiarë monetarë, ose kanë norma interesi të luhatshme, ose riçmohen brenda vitit.

### **3.14 Përdorimi i vlerësimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare individuale në përputhje me MRF dhe Ligjin për Bankat në Republikën e Shqipërisë kërkon që organet drejtuese të bëjnë vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë direkt në vlerën e raportuar të aktiveve dhe detyrimeve, në paraqitjen e vlerës së aktiveve dhe detyrimeve të mundshme në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare individuale, dhe në shumën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës raportuese. Rezultatet reale mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara.

### **3.15 Krahasueshmëria**

Politikat kontabël të adoptuara nga Banka janë konsistente me ato të paraqitura një vit më parë, përveçse kur theksohet ndryshe.

## Tregues te rentabilitetit te bankes \*

Tregues te rentabilitetit te bankes *	30/9/2020	30/6/2020	31/3/2020	31/12/2019	30/9/2019	30/6/2019
1. Kthyeshmëria nga aktivet mesatare (ROAA) [të ardhurat neto / aktivet mesatare *100];	0.9 %	0.9 %	-	2.1 %	2.2 %	2.2 %
2. Rezultati neto i jashtëzakonshëm / aktivet mesatare;	0.3 %	0.2 %	0.2 %	0.1 %	0.1 %	0.1 %
3. Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	32.4 %	33.4 %	31.8 %	23.6 %	27.2 %	28.9 %
4. Të ardhurat neto nga interesi / shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë;	135.5 %	133 %	136 %	141.0 %	144 %	142 %
5. Kthyeshmëria nga kapitali aksionar mesatar (ROAE) [të ardhurat neto / kapitali aksionar mesatar *100];	6.6 %	6.6 %	-	15.9 %	17.8 %	17.6 %
6. Aktive për punonjës [totali i aktiveve / numri i regjistruar i punonjësve] në Lek'000;	178,809	179,602	183,408	176,289	174,027	173,748
7. Të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare;	2.8 %	2.8 %	2.8 %	3.0 %	2.9 %	2.9 %
8. Marzhi neto nga interesat: [Të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare qe sjellin te ardhura]	3.4 %	3.5 %	3.5 %	3.6 %	3.6 %	3.6 %
9. Te ardhurat nga interesat / aktivet mesatare;	2.9 %	2.9 %	2.9 %	3.1 %	3.1 %	3.1 %
10. Shpenzime për interesa / aktivet mesatare;	0.1 %	0.1 %	0.1 %	0.1 %	0.1 %	0.1 %
11. Të ardhurat neto nga interesat / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	43.9 %	44.4 %	43.3 %	33.2 %	39.2 %	41.0 %
12. Të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera / aktivet mesatare;	0.7 %	0.7 %	0.7 %	1.2 %	1.2 %	1.2 %
13. Shpenzimet jo për interesa / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	82.1 %	81.9 %	99.3 %	73.7 %	66.8 %	65.4 %
14. Shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë;	16.5 %	17.0 %	15.7 %	12.1 %	13.7 %	13.8 %
15. Shpenzime për provigjone / aktivet mesatare.	0.5 %	0.4 %	1.6 %	-	-	-

(\*) Treguesit jane llogaritur sipas kerkesave te Rregullores Nr. 60, datë 29.08.2008 te Bankes se Shqiperise (i ndryshuar)



## Pasqyra e pozicionit financiar dhe zërat jashtë bilanci

në mijë Lekë

AKTIVET	30/9/2020	31/12/2019	Ndryshimi	ne %
Arka dhe Banka Qëndrore	51,083,146	30,023,090	21,060,056	70.1 %
<i>Arka</i>	8,074,492	4,804,975	3,269,517	68.0 %
<i>Banka Qëndrore</i>	43,008,653	25,218,115	17,790,538	70.5 %
Bono thesari për rifinancim me Bankën Qëndrore	5,491,177	7,690,006	(2,198,829)	(28.6)%
Hua dhe paradhënie neto për institucionet e kreditit	29,527,194	32,122,303	(2,595,109)	(8.1)%
<i>Llogari rrjedhëse</i>	871,595	896,334	(24,739)	(2.8)%
<i>Depozita</i>	25,073,839	27,423,520	(2,349,681)	(8.6)%
<i>Hua</i>	3,398,624	3,570,960	(172,336)	(4.8)%
<i>Të tjera</i>	183,136	231,490	(48,354)	(20.9)%
Hua dhe paradhënie neto për klientët	90,036,880	93,970,981	(3,934,101)	(4.2)%
<i>Hua dhe paradhënie standarde</i>	83,826,939	86,963,474	(3,136,534)	(3.6)%
<i>Hua të pakthyera në afat</i>	302,530	135,468	167,061	123.3 %
<i>Hua në ndjekje</i>	2,302,373	2,230,648	71,726	3.2 %
<i>Hua nënstandard</i>	2,545,918	3,108,193	(562,275)	(18.1)%
<i>Hua të dyshimta</i>	1,050,888	1,527,015	(476,127)	(31.2)%
<i>Hua të humbura</i>	8,232	6,184	2,048	33.1 %
Letra me vlerë	52,085,157	56,021,041	(3,935,884)	(7.0)%
<i>Letra me vlerë me të ardhura të pandryshuara</i>	50,905,055	54,844,567	(3,939,512)	(7.2)%
<i>Letra me vlerë të blera sipas marrëveshjes (REPO)</i>	1,180,102	1,176,474	3,628	0.3 %
Interesa pjesëmarrëse dhe filialet	329,205	329,205	0	0%
<i>Filialet</i>	329,205	329,205	0	0%
Mjete të mbajtura në emër të të tretëve	0	0	0	0%
<i>Administrimi fiskal</i>	0	0	0	0%
Mjetet e qëndrueshme, neto	4,567,039	4,583,945	(16,906)	(0.4)%
<i>Mjete të patrupëzuara</i>	1,265,287	1,285,430	(20,143)	(1.6)%
<i>Mjete të trupëzuara</i>	3,301,753	3,298,515	3,238	0.1 %
Mjete të tjera, neto	2,729,675	3,201,074	(471,399)	(14.7)%
<b>TOTALI I AKTIVEVE</b>	<b>235,849,473</b>	<b>227,941,645</b>	<b>7,907,828</b>	<b>3.5 %</b>

Shenim: Shifrat janë te pa audituara nga auditoret e jashtëm

## Pasqyra e pozicionit financiar dhe zërat jashtë bilanci (vijon)

në mijë Lekë

DETYRIMET	30/09/2020	31/12/2019	Ndryshimi	ne %
Detyrimet ndaj Bankës Qëndrore	-	-	0	0%
Detyrimet ndaj institucioneve të kreditit përveç B.Qëndrore	6,015,874	6,987,934	(972,061)	(13.9)%
<i>Llogari rrjedhëse</i>	1,898,027	2,164,930	(266,903)	(12.3)%
<i>Depozita</i>	4,111,609	4,816,890	(705,281)	(14.6)%
<i>Llogari të tjera</i>	6,237	6,114	122	2.0 %
Detyrimet ndaj klientëve	191,443,598	182,640,927	8,802,671	4.8 %
<i>Llogari rrjedhëse</i>	137,733,789	124,931,956	12,801,833	10.2 %
<i>Llogari depozite</i>	50,270,828	53,142,428	(2,871,600)	(5.4)%
<i>Llogari të tjera</i>	3,438,981	4,566,544	(1,127,563)	(24.7)%
Borxhi ndaj Qeverisë shqiptare dhe organizatave publike	346,446	327,673	18,773	5.7 %
Letrat me vlerë të shitura REPO	-	-	-	-
Mjete të mbajtura në emër të të tretëve	1,426,397	1,590,876	(164,478)	(10.3)%
<i>Administrimi fiskal</i>	436,800	625,753	(188,953)	(30.2)%
<i>Të tjera</i>	989,597	965,123	24,475	2.5 %
Fonde rezervë për rreziqe dhe shpenzime	1,072,301	1,179,252	(106,951)	(9.1)%
Borxh i varur	-	1,874,489	(1,874,489)	-
Detyrime të tjera	3,007,310	2,481,843	525,467	21.2 %
<b>TOTALI I DETYRIMEVE</b>	<b>203,311,926</b>	<b>197,082,994</b>	<b>6,228,932</b>	<b>3.2 %</b>
<b>KAPITALI AKSIONAR</b>				
Kapitali aksionar	14,178,593	14,178,593	0	0%
Rezerva	5,091,221	5,159,285	(68,064)	-1%
Diferenca rivlerësimi	(1,724,243)	(1,953,150)	228,907	(11.7)%
Fitimet e pashpërndara	13,473,923	8,745,290	4,728,632	54.1 %
(Humbja) / Fitimi i vitit ushtrimor	1,518,052	4,728,632	(3,210,580)	-68%
<b>TOTALI I KAPITALIT AKSIONAR</b>	<b>32,537,546</b>	<b>30,858,651</b>	<b>1,678,896</b>	<b>5.4 %</b>
<b>TOTALI I DETYRIMEVE &amp; KAPITALIT AKSIONAR</b>	<b>235,849,473</b>	<b>227,941,645</b>	<b>7,907,828</b>	<b>3.5 %</b>

në mijë Lekë

ZËRAT JASHTË BILANCIT	30/09/2020	31/12/2018	Ndryshimi	ne %
Angazhime dhe garanci të dhëna	24,273,458	23,537,546	735,911	3.1 %
Angazhime garanci të marra	1,877,450	(483,752)	2,361,202	-
Transaksione në valutë	0	0	0	-
Angazhime të tjera	0	0	0	0%

Shenim: Shifrat janë të pa audituara nga auditoret e jashtëm

## Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

në mijë Lekë	01/01 deri 30/9/2020	01/01 deri 30/9/2019	Ndryshimi	ne %
<b>Interesat</b>				
Të ardhura nga interesat	4,917,838	5,305,709	(387,871)	(7.3)%
nga veprimet e thesarit dhe ndërbankare	(3,103)	138,126	(141,229)	(102.2)%
nga veprimet me klientet	3,560,668	3,506,394	54,275	1.5 %
nga veprimet me letra me vlerë	1,359,983	1,660,589	(300,606)	(18.1)%
të tjera	290	600	(310)	(51.7)%
Shpenzime për interesa	(182,161)	(193,139)	10,978	(5.7)%
për veprimet e thesarit dhe ndërbankare	157	(1,308)	1,465	(112.0)%
per veprimet me klientet	(38,285)	(39,028)	743	(1.9)%
per borxhet e varura	(46,848)	(70,750)	23,901	(33.8)%
per veprimet me letra me vlerë	(79,650)	(63,788)	(15,862)	24.9 %
të tjera	(17,535)	(18,265)	730	(4.0)%
<b>Te Ardhurat Neto nga Interesat</b>	<b>4,735,677</b>	<b>5,112,570</b>	<b>(376,893)</b>	<b>(7.4)%</b>
Te ardhurat nga komisionet	2,106,294	2,354,809	(248,515)	(10.6)%
nga veprimet e thesarit dhe ndërbankare	9,515	210	9,305	-
nga transaksionet me klientët	397,883	473,304	(75,421)	(15.9)%
për shërbimet bankare	1,698,027	1,875,832	(177,805)	(9.5)%
komisione të tjera	870	5,463	(4,593)	(84.1)%
Shpenzime per komisionet	(769,994)	(648,160)	(121,833)	18.8 %
për veprimet e thesarit dhe ndërbankare	(68,796)	(69,755)	959	(1.4)%
për transaksionet me klientët	(246,873)	(140,447)	(106,426)	75.8 %
për shërbime bankare	(398,835)	(382,448)	(16,387)	4.3 %
komisione të tjera	(55,489)	(55,510)	21	(0.0)%
<b>Fitimi Neto nga Komisionet</b>	<b>1,336,301</b>	<b>1,706,649</b>	<b>(370,348)</b>	<b>(21.7)%</b>
Fitimi neto nga veprimtaria valutore	389,487	471,684	(82,198)	(17.4)%
Të ardhura neto nga operacionet e qirasë	4,573	4,033	541	13.4 %
Fitimi/(Humbja) neto nga veprimtaritë e tjera bankare	(441,509)	(58,729)	(382,780)	651.8 %
<b>Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë</b>	<b>(3,494,723)</b>	<b>(3,546,044)</b>	<b>51,321</b>	<b>(1.4)%</b>
Shpenzime për personelin	(1,779,455)	(1,799,180)	19,725	(1.1)%
Taksa përveç taksave mbi të ardhurat	(41,713)	(41,835)	122	(0.3)%
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë	(1,673,555)	(1,705,029)	31,474	(1.8)%
<b>Amortizimi mjeteve të qëndrueshme</b>	<b>(351,144)</b>	<b>(344,060)</b>	<b>(7,085)</b>	<b>2.1 %</b>
<b>Humbjet nga llogarite per t'u arketuar dhe shpenzimet për fondin rezervë per llogarite e dyshimta</b>	<b>(915,396)</b>	<b>617,667</b>	<b>(1,533,063)</b>	<b>(248.2)%</b>
Rimarrje /(Shpenzime) neto për fondet rezervë statistikore per huatë standarte & ne ndjekje	56,080	3,264	52,817	-
Rimarrje /(Shpenzime) neto për fonde rezervë për huatë nënstandard, të dyshimta dhe të humbura	(668,076)	1,403,282	(2,071,358)	(147.6)%
Rimarrje /(Shpenzime) neto për fonde të tjera rezervë	(88,017)	(194,346)	106,328	(54.7)%
Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme	(215,384)	(594,533)	379,150	(63.8)%
<b>Fitimi neto nga veprimtaritë jo te zakonshme</b>	<b>480,233</b>	<b>170,210</b>	<b>310,023</b>	<b>182.1 %</b>
Të ardhura jo te zakonshme	481,184	174,387	306,797	175.9 %
Shpenzime jo te zakonshme	(950)	(4,176)	3,226	(77.2)%
<b>Fitimi (Humbja) para tatimit</b>	<b>1,743,498</b>	<b>4,133,981</b>	<b>(2,390,482)</b>	<b>(57.8)%</b>
Tatimi mbi fitimin	(225,446)	(292,557)	67,111	(22.9)%
<b>Fitimi / (Humbja) neto per periudhen</b>	<b>1,518,052</b>	<b>3,841,424</b>	<b>(2,323,372)</b>	<b>(60.5)%</b>

Shenim: Shifrat jane te pa audituara nga auditoret e jashtem

## Të ardhurat dhe shpenzimet sipas tremujorëve

në mijë Lekë	T3-2019	T4-2019	T1-2020	T2-2020	T3-2020
<b>Interesat</b>					
Të ardhura nga interesat	8,939,216	(10,847,469)	1,709,148	1,591,778	1,616,912
nga veprimet me banka	237,815	(280,248)	23,904	(4,010)	(22,998)
nga veprimet me klientet	5,814,278	(6,910,498)	1,186,687	1,153,651	1,220,330
nga veprimet me letra me vlere të tjera	2,885,993	(3,655,360)	498,463	442,075	419,445
	1,130	(1,363)	93	62	134
Shpenzime për interesa	(343,608)	417,906	(64,110)	(64,717)	(53,334)
per veprimet me banka	(2,108)	2,990	127	(162)	192
per veprimet me klientet	(64,761)	76,838	(12,989)	(12,900)	(12,397)
per borxhet e varura	(177,380)	260,303	(23,516)	(23,332)	0
per veprimet me letra me vlere të tjera	(93,019)	83,789	(21,785)	(22,511)	(35,353)
	(6,340)	(6,015)	(5,948)	(5,812)	(5,776)
<b>Te Ardhurat Neto nga Interesat</b>	<b>8,595,608</b>	<b>(10,429,563)</b>	<b>1,645,037</b>	<b>1,527,061</b>	<b>1,563,578</b>
Te ardhurat nga komisionet	3,985,973	(4,663,667)	712,001	644,964	749,329
nga veprimet e thesarit dhe ndërbankare	3,147,371	(3,623,142)	2,238	7,269	7
nga transaksionet me klientët	126,712	(1,678,586)	148,556	114,512	134,815
për shërbimet bankare	711,890	638,061	561,207	522,313	614,507
komisione të tjera	-	-	-	870	-
Shpenzime per komisionet	(1,035,811)	1,039,533	(242,614)	(239,673)	(287,707)
për veprimet e thesarit dhe ndërbankare	(503,910)	871,460	(22,959)	(18,835)	(27,002)
për transaksionet me klientët	(343,894)	348,694	(69,392)	(84,873)	(92,608)
për shërbime bankare	(169,550)	(161,022)	(132,029)	(117,365)	(149,441)
komisione të tjera	(18,457)	(19,598)	(18,234)	(18,600)	(18,655)
<b>Fitimi nga komisionet, neto</b>	<b>2,950,162</b>	<b>(3,624,134)</b>	<b>469,388</b>	<b>405,291</b>	<b>461,622</b>
Fitimi neto nga veprimtaria valutore	906,709	(1,129,726)	105,216	138,422	145,848
Të ardhura neto nga operacionet e qirasë	7,342	(9,628)	1,360	1,710	1,504
Fitimi/(Humbja) neto nga veprimtaritë e tjera bankare	(38,329)	(152,379)	(143,231)	(128,273)	(170,005)
<b>Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë</b>	<b>(6,059,190)</b>	<b>7,298,663</b>	<b>(1,207,252)</b>	<b>(1,179,409)</b>	<b>(1,108,062)</b>
Shpenzime për personelin	(3,038,567)	3,555,597	(597,846)	(616,598)	(565,011)
Taksa përveç taksave mbi të ardhurat	(45,181)	53,475	(4,371)	(34,119)	(3,223)
Shpenzime për shërbime të jashtme	(2,975,442)	3,689,591	(605,035)	(528,692)	(539,828)
<b>Amortizimi mjeteve të qëndrueshme</b>	<b>(597,774)</b>	<b>762,465</b>	<b>(114,925)</b>	<b>(115,490)</b>	<b>(120,729)</b>
<b>Humbjet nga llogaritë për t'u arkëtuar dhe shpenzimet për fondin rezervë për llogaritë e dyshimta</b>	<b>722,192</b>	<b>(921,591)</b>	<b>(912,253)</b>	<b>470,519</b>	<b>(473,661)</b>
Rimarrje /(Shpenzime) neto për fondet rezervë statistikore per huatë standarte & ndjekje	354,537	(791,716)	(74,851)	100,186	30,745
Rimarrje /(Shpenzime) neto për fonde rezervë për huatë nënstandard, të dyshimta dhe të humbura	2,216,127	(698,276)	(612,407)	341,158	(396,826)
Rimarrje /(Shpenzime) neto për fonde të tjera rezervë	(364,455)	479,996	(133,148)	(22,631)	67,763
Humbje nga llogaritë për t'u arkëtuar të pambledhshme	(1,484,017)	88,405	(91,847)	51,806	(175,342)
<b>Fitimi neto nga veprimtaritë jo te zakonshme</b>	<b>131,399</b>	<b>1,589</b>	<b>120,472</b>	<b>83,570</b>	<b>276,192</b>
Të ardhura jo te zakonshme	228,479	(172,997)	122,949	81,561	276,673
Shpenzime jo të zakonshme	(97,080)	174,586	(2,477)	2,008	(481)
<b>Fitimi (Humbja) para tatimit</b>	<b>6,618,118</b>	<b>(8,204,305)</b>	<b>(36,188)</b>	<b>1,203,401</b>	<b>576,286</b>
Tatimi mbi fitimin	(350,062)	457,470	(140,037)	(25,944)	(59,465)
<b>Fitimi (Humbja) neto per periudhen</b>	<b>6,268,056</b>	<b>(7,746,835)</b>	<b>(176,225)</b>	<b>1,177,456</b>	<b>516,821</b>

Shenim: Shifrat jane te pa audituara nga auditoret e jashtem

0

## Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit

në mijë Lekë	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme	Rezerva ligjore	Rezerve rivleresimi ndertesat	Diferenca rivlerësimi	Fitimi i pashpërndarë	Fitimi i periudhes	Totali
<b>Gjendja më: 01/01/2020</b>	<b>14,178,593</b>	<b>1,852,979</b>	<b>1,417,859</b>	<b>1,888,447</b>	<b>(1,953,150)</b>	<b>8,745,290</b>	<b>4,728,632</b>	<b>30,858,651</b>
Kalim ne fitim i pashperndare	0	0	0	0	0	4,728,632	(4,728,632)	<b>0</b>
Diference Rivleresimi Kapitali	0	0	0	0	228,907	0	0	<b>228,907</b>
Rezerve rivleresimi per ndertesat	0	0	0	(68,064)	0	0	0	<b>(68,064)</b>
Pagese dividendi	0	0	0	0	0	-	0	<b>-</b>
Fitimi (Humbja) neto për periudhen	0	0	0	0	0	0	1,518,052	<b>1,518,052</b>
<b>Gjendja më: 30/9/2020</b>	<b>14,178,593</b>	<b>1,852,979</b>	<b>1,417,859</b>	<b>1,820,383</b>	<b>(1,724,243)</b>	<b>13,473,923</b>	<b>1,518,052</b>	<b>32,537,546</b>

në mijë Lekë	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme	Rezerva ligjore	Rezerve rivleresimi ndertesat	Diferenca rivlerësimi	Fitimi i pashpërndarë	Fitimi i periudhes	Totali
<b>Gjendja më: 01/01/2019</b>	<b>14,178,593</b>	<b>1,852,979</b>	<b>1,417,859</b>	<b>1,980,334</b>	<b>(1,787,493)</b>	<b>4,446,059</b>	<b>6,267,364</b>	<b>28,355,694</b>
Kalim ne fitim i pashperndare	0	0	0	0	0	6,267,364	(6,267,364)	<b>0</b>
Diference Rivleresimi Kapitali	0	0	0	0	(131,521)	0	0	<b>(131,521)</b>
Rezerve rivleresimi per ndertesat	0	0	0	(68,915)	0	(1,968,132)	0	<b>(2,037,048)</b>
Pagese dividendi	0	0	0	0	0	-	0	<b>-</b>
Fitimi (Humbja) neto për periudhen	0	0	0	0	0	0	3,841,424	<b>3,841,424</b>
<b>Gjendja më: 30/9/2019</b>	<b>14,178,593</b>	<b>1,852,979</b>	<b>1,417,859</b>	<b>1,911,419</b>	<b>(1,919,015)</b>	<b>8,745,290</b>	<b>3,841,424</b>	<b>30,028,549</b>

## Pasqyra e rrjedhjes së parashë

në mijë Lekë

	01-01 deri 30/9/2020	01-01 deri 30/9/2019
<b>Flukset monetare nga aktiviteti operacional Fitimi (Humbja) i vitit ushtrimor</b>	<b>1,518,052</b>	<b>3,841,424</b>
<b>2. Zera Jo-Monetar ne pasqyren e rrjedhjes se parase</b>		
Zhvleresimi / amortizimi	419,208	412,975
Mjeteve te qendrueshme nxjerre jashte bilanci	610	15,492
Shpenzimet për fondet rezervë	3,499,545	3,190,357
(Transferime nga fondet rezerve)	(2,867,596)	(4,421,704)
(Rritje)/Paksim ne interesat per t'u arketuar	38,666	(38,658)
Rritje/(Paksim) ne interesat per t'u paguar	(29,752)	21,368
Efekti i zërave të tjerë të përlogaritur dhe të shtyrë	(399,214)	(63,383)
Diferenca e rivlerësimit	228,907	(131,521)
<b>3. Rrjedhja e parase nga aktiviteti operacional perpara ndryshimeve ne kapitalin qarkullues (1+2)</b>	<b>2,408,426</b>	<b>2,826,348</b>
<b>4. Ndryshime ne kapitalin qarkullues</b>		
